



Buletini Mjedisor

NGA 580 HEC VETËM 150 JANË ME LEJE MJEDISORE

Prej 6 muajsh, Ministria e Mjedisit ka ngritur një grup pune për të kontrolluar aktivitetin e HEC-eve në Shqipëri, nëse i janë nënshtruar procesit të marrjes së lejes mjedisore.

Prodhimi i energjisë nga burime hidrike është një arritje mjedisore të cilën Ministria e Mjedisit e mbështet, por problem kryesor qëndron në abuzimin që është bërë me dhënien e lejes për ndërtimin e këtyre HEC-ve.

Deri sot, në Shqipëri, rezultojnë rreth 480 subjekte që kanë marrë leje koncesionare për ndërtimin e HEC-ve në lumenjtë e vendit, disa prej këtyre subjekteve ju është dhënë leja për të zhvilluar aktivitetin e tyre në zona të mbrojtura, çka ka qënë në kundërshtim

me legjislacionin mjedisor.

Duke u gjendur përballë këtij realiteti Ministri i Mjedisit i ka kërkuar Inspektoriatit Kombëtar të Pyjeve dhe Mjedisit të ushtrorë një kontroll mbi këtë lloj aktiviteti që ka ndikim në mjedis.

Pas inspektimit kryeinspektori i Mjedisit z. Ergys Agasi ka deklaruar se është konstatuar se nga 480 subjekte të lejuara për ndërtimin e HEC-ve, vetëm 180 prej tyre kanë aplikuar dhe janë pajisur me leje mjedisore, pjesa tjetër nuk ka aplikuar dhe nuk kanë lejet e nevojshme mjedisore.

Gjithashtu gjatë kontrollit të ushtruar deri tani në 30 subjekte, Kryeinspektori Agasi thekson se “Problemi kryesor që vihet re në objektet e ndërtuara është dëmtimi i pyjeve përreth zonës, sepse ndërtuesit përpiqen të shkurtojnë punën e tyre në

dëm të mjedisit pa respektuar kushtet e lejes mjedisore”.

Nga inspektimi rezultojnë se një numër i madh i subjekteve nuk kanë filluar punimet. Vetëm një rast në Qarkun Lezhë është identifikuar që ka filluar punën pa marrë leje mjedisore. Në këtë rast subjekti përveçse vendosjes së gjobës është çuar dhe për ndjekje penale.

Kryeinspektori Agasi thekson se “Për subjektet që janë pajisur me leje mjedisore, ne do të shikojmë me rigorozitet shtatimin e kushteve të vëna në këto leje si dhe do të jetë rikthimi i zonës në gjendjen fillestare pas ndërtimit të HEC”.

MONITOROHET CILËSIA E UJËRAVE DETARE, ULET NDOTJA NË 2015



Monitorimi dixhital i cilësisë së ujërave larës përgjatë gjithë vijës bregdetare në vend për vitin 2015, u prezantuan në Maj përmes një konference për shtyp, ku morën pjesë ministri i Mjedisit Lefter Koka dhe drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, z. Julian Beqiri.

Në fjalën e tij Ministri Koka vlerësoi punën e shkëlqyer të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit në monitorimin e mjedisit të sjellë tashmë në standarde evropiane. Më tej ministri Koka u shpreh i kënaqur që nga rezultatet vihet re një rritje e cilësisë së ujërave bregdetare me 20 për qind krahasuar me një vit më parë.

“Gjej rastin t’u shpreh mirënjohjen disa prej komunave apo bashkive që kanë punuar mirë në këtë drejtim si në plazhin e Kavajës, Durrësit, Sarandës, Qeparoit, Shëngjinit apo Velipojë të cilët me të vërtetë kanë një situatë relativisht shumë pozitive. U bëj thirrje edhe njëherë të gjithë kryetarëve të komunave dhe bashkive që të marrin masat e nevojshme. Detyrimet vazhdojnë deri në ditën e dorëzimit të detyrës. Është një mision, një detyrë funksionale e tyre për të përmirësuar gjendjen në ato zona ku është e nevojshme”, tha ministri Koka.

Por sipas ministrit të Mjedisit, gjendja e 6 baseneve në Shqipëri ka rezultuar jo fort e këndshme. “Ministria e Mjedisit do të marrë masat për të pezulluar ato kompani që janë ndotës së lumenjve”, u shpreh ai.

Më tej Drejtori i Agjencisë Kombëtare të

Mjedisit z. Julian Beqiri prezantoi në detaje monitorimin e kryer në 78 pika të ndryshme në 12 plazhe të vendit duke theksuar se për herë të parë Agjencia po kryen monitorimin dixhital të mjedisit. Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) ka kryer monitorimin për plazhet: Velipojë, Shëngjin, Durrës, Gjiri i Lalzit, Kavajë, Vlorë, Sarandë, Ksamil, Dhërmi, Himarë, Qeparo dhe Borsh.

RENDITJA E PLAZHEVE MË TË PASTRA

Agjencia Kombëtare e Mjedisit çdo vit kryen monitorimin e cilësisë së ujërave bregdetare të larjes. Ky monitorim është pjesë përbërëse kryesore e Planit të Veprimit për Mesdheun. Qëllimi i këtij studimi është vlerësimi dhe njohja e cilësisë mikrobiologjike të ujërave bregdetare të larjes në 12 plazhet kryesore të vendit tonë ku përfshihen plazhet: Velipojë, Shëngjin, Durrës, Gjiri i Lalzit, Kavajë, Vlorë, Sarandë, Ksamil, Dhërmi, Himarë, Qeparo, Borsh.

Aktualisht është realizuar 1 seri monitorimi para fillimit të sezonit 11-25 maj 2015. Monitorimi ka filluar në datën 11 Maj 2015 dhe do të mbarojë në 30 Shtator 2015, për punën në terren (marrja e mostrave të ujërave për analizat mikrobiologjike, matja e temperaturës, pH dhe ekspertiza higjieno-sanitare e plazheve). Deri tani është mbaruar seria e parë e monitorimit për të gjitha plazhet e përfshira në monitorim. Në datën 1 Qershor fillon seria e dytë e monitorimit. Çdo muaj do të merren 2 seri kampionimi. Janë gjithsej 9 fushata kampionimi që do të kryhen për çdo plazh të përfshirë në skemën e monitorimit. Mostrat e ujërave janë analizuar për dy

tregues mikrobiologjik. Nga analizat mikrobiologjike për cilësinë e ujërave të larjes në plazhet e mësipërme, për serinë e parë të monitorimit para fillimit të sezonit turistik të larjes rezultojnë se janë ulur plazhet me ndotje të lartë, e krahasuar kjo me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ky përmirësim është ndërjet me shumë sidomos për plazhin e Kavajës dhe të Durrësit, pas futjes së shkarkimeve urbane në sistem kanalizimesh dhe dërgimi i tyre në impiantet e trajtimit të ujërave urbane të Durrësit dhe të Kavajës.

Plazhi i Durrësit

Në 21 pika të monitoruara nga viti 2014 në 2015 kemi përmirësime të dukshme në cilësinë e ujërave kështu ne qoftë se në vitin 2014 për plazhin e Durrësit kishim 13 pika problematike në 2015 kemi vetëm 5 pika për sa i përket serisë së parë të monitorimit. Një përmirësim i dukshëm në plazhin e Durrësit është bërë në drejtim të disiplinimit të shkarkimeve urbane. Pjesa më problematike e plazhit të Durrësit tek Shkëmbi i Kavajës, ishte futur në sistem kanalizimesh deri tek Përoi i Agait, ku shkarkimet urbane të lëngëta me anë të stacioneve të pompave të ngritura përgjatë bregdetit, kalojnë në Impiantin e Trajimit të Ujërave Urbane të Durrësit, për tu trajtuar.

Gjatë inspektimit, nuk u konstatuan shkarkime urbane në det, nga subjektet. Nga shkarkimet e Kanalit të Madh tek Plepat nuk kundërmohej era karakteristike putrifikuase e shkarkimeve urbane e viteve më parë. Edhe nga analizat mikrobiologjike të kryera në këtë pikë monitorimi, ka një përmirësim të dukshëm të rezultateve.

NË KËTË NUMËR:

NGA 580 HEC VETËM 150 JANË ME LEJE MJEDISORE FQ 1

MONITOROHET CILËSIA E UJËRAVE DETARE, ULET NDOTJA NË 2015

LEJET MJEDISORE FQ 4

“Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimit të cilësisë së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përbushja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, xituar dhe bashkë-renduar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenie afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilitëzin opinionin publik”.



Bashkëpunimi mjedisor dhe partneriteti ishin tema qendrore e Takimit Vjetor 2015 të Qendrave të Aarhusit, organizuar nga zyra e Koordinatorit të OSBE-së për çështjet ekonomike dhe mjedisore, në datat 3-4 Qershor 2015, Austri.

Si pjesë e Takimit Vjetor të Qendrave të Aarhusit për vitin 2015, u nënshkrua edhe Deklarata e Përbashkët për Bashkëpunim mes qendrave të Aarhusit të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Malit të Zi dhe Serbisë.

Përmes kësaj Deklaratë për Bashkëpunim, qendrat e Aarhusit të vendeve të rajonit konfirmojnë përkushtimin e tyre për të forcuar partneritetin dhe bashkëpunim mes 13 Qendrave të Aarhusit të Europës Juglindore, me qëllim nxitjen e zbatimit të Konventës së Aarhusit, lehtësimin e dialogut mes organizatave të shoqërisë civile përtej kufijve kombëtare dhe adresimin e shqetësimeve të përbashkëta mjedisore në mënyrë më

efiçente.

Ideja për nënshkrimin e kësaj deklarate për bashkëpunim ka dalë nga takimi rajonal "Forcimi i pjesëmarrjes së publikut në menaxhimin ndërkufitar të ujrave – sinergjia mes Konventës së ESPOO-s, Helsinkut dhe Aarhusit, i mbajtur në Tiranë, në datat në 25-26 Mars të këtij viti.

Nënshkrimi i kësaj deklarate ka patur jehonë dhe nxitur deklarata për shtyp të nivelit të lartë, si deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm, z. Lamberto Zannier dhe Z. Ivica Dačić, në funksionin e tij si President i radhës i OSBE-së, të cilët e kanë mirëpritur ngritjen e bashkëpunimit të Qendrave të Aarhusit nga niveli kombëtar tek ai rajonal.

OSBE ka mbështetur krijimin dhe funksionimin e Qendrave të Aarhusit që prej vitit 2002, kryesisht përmes Nismës për Mjedis dhe Siguri (ENVSEC). Aktualisht funksionojnë 59 qendra Aarhusi në 14 vende të ndryshme, me mision nxitjen e zbatimit të Konventës

së Aarhusit për të drejtën e informimit, pjesëmarrjen e publikut në vendim-marrje mjedisore dhe të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës për çështje mjedisore.

Qeveritë e Austrisë, Finlandës, Norvegjisë, Suedisë, Zvicrës dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë ndër vendet kryesore që mbështesin aktivitetet e Qendrave të Aarhusit.

Qendrat e Aarhusit janë një platformë bashkëpunimi dhe partneriteti mes shoqërisë civile, institucioneve qendrore dhe vendore dhe publikut të gjerë për çështje të sigurisë dhe mjedisit. Ato u vijnë në ndihmë qeverive për të zbatuar detyrimet që vijnë nga Konventa dhe qytetarëve për të kuptuar dhe ushtruar të drejtën e tyre, sipas Konventës.

Në Shqipëri janë tre qendra Aarhusi, të krijuara me mbështetjen e OSBE-së: në Tiranë (në Ministrinë e Mjedisit), në Vlorë dhe në Shkodër.

MONITOROHET CILËSIA E UJËRAVE DETARE, ULET NDOTJA NË 2015

Plazhi i Kavajës

Këtë vit ishin bërë përmirësime të dukshme në sistemin e largimit të shkarkimeve urbane të lëngëta dhe në infrastrukturë, por akoma nuk mund të themi se në këtë plazh janë mbaruar të gjitha lidhjet sidomos ato dytësore dhe terciare. Shkarkimet urbane tek Përroi i Agait, i cilësuar si një zone problematike, pompohen për tek Impianti i Trajtitimit të Ujërave Urbane të Durrësit duke sjelle përmirësime të dukshme në cilësinë e ujit në këtë zone. Gjatë segmentit nga Përroi i Agait deri në pikën fundore të monitorimit, tek ish Fusha e Sportit, e cila e kap zona e Qerretit, janë vënë në funksion 5 stacione pompimi, të cilët bëjnë largimin e shkarkimeve urbane të lëngëta drejt Impiantit të Trajtitimit të Ujërave Urbane në Kavajë, ku edhe në këtë të fundit është bërë zgjerimi i vaskave ekzistuese. Theksojmë se shkarkimet urbane të zonës nga Kompleksi Murrizi deri tek Godina e Policisë së Shtetit, të cilat vitet e mëparshme drenoheshin nëpërmjet një kanali të hapur në natyrë, janë futur në sistemin e kolektorit kryesor. Në këtë kolektor shkarkohen ujërat urbane të gjithë bizneseve në të dy anët e rrugës, ndërkohë që për lidhjet dytësore, në këtë segment, janë përfunduar vetëm rreth 20% e tyre. Subjektet e tjera akoma vazhdojnë më gropa septike. Nga analizat mikrobiologjike për serinë e parë para fillimit të sezonit turistik, rezultojnë se, nga 10 pika monitorimi vetëm 3 prej tyre rezultojnë me ngarkesë mikrobiologjike të lartë. Ndërsa, në të njëjtën periudhë të vitit 2014, ndoia bakteriale ka qenë shumë herë më e lartë dhe pothuajse në të gjitha pikat e monitorimi.

Plazhi i Sarandës

Përmirësime në largimin e ujërave urbane janë bërë edhe në qytetin e Sarandës, ku Impianti i Trajtitimit të Ujërave urbane është vënë në funksion, ç'ka u vërtetua edhe nga analizat mikrobiologjike të ujërave të marra

në pikën e monitorimit në Kanalin e Çukës, ku ndoia mikrobiologjike rezultoi shumë herë më e ulët se një vit më parë, në periudhën para fillimit të sezonit turistik. Megjithatë, në këtë plazh ka akoma, shkarkime të subjekteve, që derdhen direkt në det duke shkaktuar ndotje të konsiderueshme të ujërave tek pika e monitorimit tek plazhi i ri.

Plazhi i Ksamilit

Në Ksamil, cilësia e ujërave të detit në serinë e parë, para fillimit të sezonit të larjes, vazhdon të mbetet shumë e mirë. Në inspektimin e kryer u konstatua se nga subjekte private kishin filluar të merreshin masa higjieno-sanitare, në pastrimin e rërës dhe në vendosjen e koshave të mbeturinave si dhe njeje higjieno-sanitare

Plazhi i Qeparoit

Përmirësime të dukshme në krahasim me një vit më parë, ishin bërë edhe në plazhin e Qeparoit, ku të gjitha shkarkimet urbane të banesave që shtrihen përgjatë vijës bregdetare, në pjesën e sipërme të saj, ishin futur në sistem kanalizimesh. Në këtë plazh nuk ka shkarkime urbane të subjekteve. Rezultatet analitike të kryera për vitin 2015, në serinë e parë rezultojnë brenda normave për cilësinë A- Cilësi e Shkëlqyer e Ujërave, e krahasuar me rezultatet e një viti më parë, ku ndoia mikrobiologjike ishte e një shkalle të lartë.

Plazhi i Vlorës

Në plazhin e Vlorës vazhdon të ketë shkarkime të ujërave urbane, në zonën tek Shkolla e Marinës, e cila vërtetohet edhe nga rezultatet mikrobiologjike të ujërave në vazhdon të mos funksionojë. Plazhet e tjera të monitoruara rezultojnë të pastra.

Plazhi i Shëngjinit

Përmirësime të dukshme në sistemin e largimit të shkarkimeve urbane janë bërë dhe po vazhdojnë të bëhen edhe në plazhin e Shëngjinit, ku shkarkimet urbane mbledhen në sistemin e kolektorit kryesor për tu derdhur në Impiantin e trajtimit të ujërave urbane të Lezhës. Duke sjelle kështu që ky plazh të renditet në plazhet me cilësi shumë të mirë të ujërave.

Plazhet e tjera të monitoruara për serinë e parë, para fillimit të sezonit turistik, si plazhi i Velipojës, Dhërmiut, Borshit rezultojnë të pastra, sipas analizave mikrobiologjike të kryera për serinë e parë të monitorimit. Faktori kryesor i ndotjes së ujërave bregdetare të larjes mbeten shkarkimet e ujërave urbane të pa trajtuara në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte, të cilat shkaktojnë ndotje të ujërave bregdetare të larjes.

Në plazhet në të cilat janë ngritur dhe funksionojnë sistemi i kanalizimeve të shkarkimeve urbane, vërehet përmirësim i cilësisë së ujërave, siç janë plazhi i Kavajës, Durrësit, Sarandës, Qeparoit, Shëngjinit, Velipojës etj.

Mos funksionimi i Impianteve të Trajtitimit të Ujërave urbane si në Vlorë, reflektohen në impaktin negativ të ndotjes së ujërave dhe përkeqësimin e gjendjes së cilësisë së ujërave të larjes, siç është plazhi tek Shkolla e Marinës.

Nga inspektimet higjieno-sanitare të bëra në terren dhe rezultatet analitike, rezultojnë se përmirësimet në infrastrukturën e kanalizimeve dhe shërbimeve të tjera në dobi të popullatës, në krahasim me një vit më parë, në të njëjtën periudhë monitorimi, kanë sjellë përmirësime të dukshme në cilësinë e ujërave larëse, duke ulur ndjeshëm ndotjen e tyre. Këtu përmendim investimet e bëra në infrastrukturë në plazhet e Shëngjinit, Velipojës dhe në plazhin e Durrësit, Kavajës, Qeparoit, Sarandës etj.

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS MAJ 2015

Nr.	Subjekti	Aktiviteti	Vendodhja	Vendimi
1	A L X H E F	VP Përpunim i lëndës drusore dhe prodhim pelleti nga mbetjet e saj	Fushë Prezë, Prezë, Tiranë	Vendim Paraparak
2	TONA - ALB	VP Impiant për therjen e bagëtive dhe përpunimit të mishit.	Korçë	Vendim Paraparak
3	MARGIS-Italia 2463	VP Resort turistik vila 2-3 kate (zonimi 2)	Tale, Lezhë	Refuzim Vendim Paraparak
4	MARGIS-Italia 2465	VP Resort turistik vila 2-3 kate (zonimi 1)	Tale, Lezhë	Refuzim Vendim Paraparak
5	DEVOLL HYDROPOWER 2441	VP Ndërtim i shtëpive zëvendësuese për personat që preken nga ndërtimi dhe operimi i rezervuarit të Banjës.	Cërrunjë, Pishaj, Gramsh, Elbasan	Refuzim Vendim Paraparak
6	DEVOLL HYDROPOWER 2447	VP Ndërtim i shtëpive zëvendësuese për personat që preken nga ndërtimi dhe operimi i rezervuarit të Banjës.	Cingar I poshtëm, Pishaj, Gramsh, Elbasan	Vendim Paraparak
7	DEVOLL HYDROPOWER 2450	VP Ndërtim i shtëpive zëvendësuese për personat që preken nga ndërtimi dhe operimi i rezervuarit të Banjës.	Drizë, Pishaj, Gramsh, Elbasan	Vendim Paraparak
8	DEVOLL HYDROPOWER 2451	VP Ndërtim i shtëpive zëvendësuese për personat që preken nga ndërtimi dhe operimi i rezervuarit të Banjës.	Dushk, Sulk, Gramsh, Elbasan	Vendim Paraparak
9	DEVOLL HYDROPOWER 2452	VP Ndërtim i shtëpive zëvendësuese për personat që preken nga ndërtimi dhe operimi i rezervuarit të Banjës.	Gramsh, Elbasan	Vendim Paraparak
10	DEVOLL HYDROPOWER 2456	VP Ndërtim i shtëpive zëvendësuese për personat që preken nga ndërtimi dhe operimi i rezervuarit të Banjës.	Qerret, Pishaj, Gramsh, Elbasan	Vendim Paraparak
11	DEVOLL HYDROPOWER 2458	VP Ndërtim i shtëpive zëvendësuese për personat që preken nga ndërtimi dhe operimi i rezervuarit të Banjës.	Kodovjat, Gramsh	Vendim Paraparak
12	KALDAJA	VP Ndërtim kaponon industrial 1 kat	Durrës, afër Shkozet	Vendim Paraparak
13	RD-2	VTH Shfrytëzim guri gelqeror	Gurras, Korçë	Refuzim Deklarate
14	DARDHA BIO	VTH Rritje shpendësh	Konisbaltë, Berat	Vendim Paraparak
15	Edonil Konstruksion	VP Kompleks turistik	Plazhi Dralleos, Palase, Himarë, Vlorë	Vendim Paraparak
16	KAZAZI-MEAT sh.p.k	VP Kapanon agro industrial	Kanaparaj, Golem, Tiranë	Vendim Paraparak
17	MINING FERRO NIKEL	VTH Shfrytëzimi i mineralit Krom	Mëhale, Bytyc, Kukës	Refuzim Deklarate
18	ISOTECK-ALBANIA	VP Kapanon industrial	Muça, Vorë, Tiranë	Vendim Paraparak
19	HABIL LEPURI	VP Ndërtim Kapanoni industrial	Grabjan, Lushnje	Vendim Paraparak
20	AGI KONS	VP Ndërtim Kompleks Hotelerie	Farkë, SelitëTiranë	Vendim Paraparak

5 QERSHORI 2015– AKTIVITETET NDËRGJEGJËSUESE TË NDËRRMARRA NË KËTË DITË



World Environment Day
Seven Billion Dreams.
One Planet.
Consume with Care.
June 5

Në kuadër të 5 Qershorit, Ditës Botërore të Mjedisit, Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka zhvilloi një vizitë në Leskovik të Kolonjës. Në takimin me banorët të zonës, ishin të pranishëm deputetja e zonës, znj. Arta Dade si dhe përfaqësues të ndryshëm të pushtetit lokal të këtij qyteti.

Duke marrë fjalën para të pranishmëve, Ministri Koka theksoi se Kolonja ka pasuri natyrore të cilat do të vihen në qendër të vëmendjes së politikës mjedisore bazuar në reformën e re territoriale.

“Bashkia e re e Kolonjës do të ketë në strukturën e saj Drejtorinë e Administrimit të Fondit Pyjor, e cila do të jetë përgjegjëse për ta administruar këtë aset në të mirë të qytetarëve të saj. Për këtë po punohet fort edhe në bashkëpunim me hallkat e tjera të Qeverisë të cilat janë në procesin e hartimit të Ligjit për Funkcionimin e Pushtetit Vendor.” – tha ministri Koka.

Në vijim të Letrës së Hapur dërguar të gjithë kandidatëve për njësitë vendore, Ministri Koka përsëriti rëndësinë e përfshirjes në program të çështjeve mjedisore. Ai i siguroi përfaqësuesit e këtij komuniteti për një bashkëpunim të mëtejshëm në investimet që do të ruajnë natyrën e Kolonjës si: ngritjen e pikave të informimit për vizitorët e turistët, në Shelegurë, dhe Radovë, ngritjen e pikave të vrojtimit për zjarret në pyje, rehabilitim në zonat mbrojtura Gërmenj-Shelegurë dhe Piskal-Shqeri si dhe sigurimin e fondeve për ripërtitjen e pyjeve dhe hartimin e projekteve të pyllëzimit dhe përmirësimit të sipërfaqeve pyjore të dëmtuara, si dhe të djegura në zona të tilla si Gërmenj, Ballabanovë etj.

Po në këtë ditë me nismën e Ambasadës Italiane nëpërmjet linjave tregtare CONAD nisi ndërgjegjësimin e qytetarëve për të reduktuar përdorimin e qeseve plastike. Në këtë aktivitet sensibilizues morri pjesë

përfaqësuesja e UN në Shqipëri, znj. Zineb Touimi-Benjelloun, Shefi i OSCE në Shqipëri, Z. Florian Raunig si dhe Drejtori i Mjedisit në Ministrinë e Mjedisit z. Redi Baduni.

Gjatë këtij aktiviteti sensibilizues u kërkua nga qytetarët një qëndrim më mjedisor, përpara se të veprimë duhet të mendojmë paraprakisht për ambientin ku jetojmë. Qeset plastike që jepen falas nga marketet tona i kanë sjellë një imazh negative Shqipërisë, pasi kanë pushtuar brigjet e lumenjve e anët e rrugëve. Kjo situatë ka ndryshuar kohët e fundit nga aksionet e ndërrmarrja qoftë nga qeveria qoftë nga shoqëria civile, ndërsa ndërgjegjësimi i qytetarëve është një nga sfidat që vazhdon të angazhojë jo vetëm Ministrinë e Mjedisit, por dhe aktorë të tjerë që punojnë në këtë fushë në Shqipëri.



LEJET MJEDISORE MAJ 2015

NR.	SUBJEKTI	AKTIVITETI	VENDNDODHJA	VENDIMI	TIPI I LEJES
1	K-AKS	TRAJTIME SIPERFAQËSORE TË METALEVE DHE PLASTIKAVE DUKE PËRDORUR PROCESHE ELEKTROLITIKE OSE KIMIKE. PRODHIMI I PRODUKTEVE PREJ PLASTIKE.	QERRET, KATUND I RI, DURRËS.	MIRATIM	TIPI B
2	GENTARI	MINIERAT NËNTOKËSORE DHE VEPRIMTARITË E LIDHURA ME TO	“GALERIA NR.36 DHE NR.38”. ZONA QENDRORE BULQIZË, DIBËR.	MIRATIM	TIPI B
3	VËLLEZËRIT HYSA (LC-2911)	PRODHIM I PRODUKTEVE ABRASIVE DHE PRODUKTEVE TË TJERA MINERALE JOMETALIKE.	KOMUNA GOSTIME, EL-BASAN.	MIRATIM	TIPI B
4	VËLLEZËRIT HYSA (LC-2916)	PËRZIERJA E ÇIMENTOS OSE PËRDORIMI I ÇIMENTOS NË MASË TË MADHE POR JO NË SHESHIN E NDËRTIMIT PËRFSHIRË AMBALAZHIMIN DHE PËRZIERJEN E ÇIMENTOS, GRUMBULLIMI I BETONIT DHE PRODHIMI I BLOQVEVE TË BETONIT DHE PRODUKTEVE TË TJERA TË ÇIMENTOS	KOMUNA KLOS, ELBASAN	REFUZIM	TIPI B
5	2 AT	VEPRIMTARI TË LIDHURA ME SUBSTANCAT DHE PREPARATET KIMIKE	BULGAREC, KORÇË.	REFUZIM	
6	BETIM MEMA	PRODHIM I ALKOLIT DHE I PIJEVE ALKOLIKE	KOMUNA LEKAJ, KAVAJË, QARKU TIRANË.	MIRATIM	TIPI B

JAVA E RICIKLIMIT—PROJEKTET QË DO MUNDËSOHEN NË FUSHËN E MBETJEVE

Java e tretë e qershorit është shpallur si Java e riciklimit, dhe për Shqipërinë, iniciativë kjo që mundëson ndërgjegjësimin e banorëve të ndërmarrin nisim që sjellin reduktimin e mbetjeve.

Shpesh imazhi i të huajve për Shqipërinë, pasi komentojnë pozitivisht klimën, traditat ushqimike dhe gjeografikë e vendit, përfundojnë me komente për mbetje kryesisht plastike, që kishin pushtuar të gjitha rrugët kombëtare apo jo.

Edhe pse flitej shumë për plehrat në Shqipëri, në vite është bërë shumë pak për menaxhimin e mbetjeve që ne krijojmë.

Sinjale pozitive u vunë re që në ditën e parë të Qeverisë së krijuar në Qershor 2013, ku vendimi i parë i kësaj Qeverie ishte ndalimi i eksporti të mbetjeve, problem shumë i kontestuar ky si nga shoqëria civile, por dhe politika. Në muajt në vazhdim u vu re se menaxhimi i integruar i mbetjeve do ishte përparsia kryesore e Ministrisë së Mjedisit, e cila e shpalli një nga prioritetet e punës së saj, menaxhimin e integruar të mbetjeve. Duke qenë se Mbetjet kishin një startegji të miratuar që në 2010, Ministri i Mjedisit krijoi Komitetin për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve si një strukturë që do koordinojë në mënyrë të vazhduar këtë proces. Pjesë të këtij Komiteti janë zëvendësministarët e një sërë Ministrish të cilat në mënyrë të drejtëpërdrejtë apo të tërthortë janë pjesë e mekanizmit për të menaxhuar mbetjet.

Por Ministria e Mjedisit po punon jo vetëm në fushën e krijimit të politikave, por dhe në atë të krijimit real të mundësisë së implementimit të Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Mbetjeve. Kështu në vijim të këtij prioriteti, janë vendosur objektiva konkretë për reduktimin e mbetjeve nëpërmjet riciklimit apo formave të tjera të përpunimit të tyre. Për të arritur këtë qëllim, është thelbësore ngritja e një sistemi të ri të reduktimit të mbetjeve duke filluar me ndarjen në burim të mbetjeve dhe konceptin “3R” (reduktim, ripërdorim, dhe riciklim), duke pasur parasysh që sasia e mbetjeve është gjithmonë në rritje.

Për mundësimin e kësaj reforme në të konceptuar dhe të vepruar, Qeveria Shqiptare i kërkoj ndihmë donatorëve të ndryshëm dhe ishte Qeveria Japoneze, e cila po asiston me një

projekt trevjeçar (2014-2017), projekt i cili po mbështet minimizimin (reduktimin) e mbetjeve dhe promovimin e konceptit “3R”.

Ky projekt do mund të sigurojë sjelljen e ekspertizës së tyre në fushat e (i) menaxhimin e mbetjeve, (ii) në politikën dhe zbatimin në praktikë të konceptit “3R”, (iii) ndërgjegjësimin e publikut/edukimin mjedisor, (iv) hartimin e masave administrative dhe politike dhe (v) metodat e përfshirjes së të gjithë palëve të interesuara në praktikën 3R

Gjithashtu ky projekt do të mundësojë trajnimin e stafit që merren me menaxhimin e integruar të mbetjeve, modulet që do përfshihen në këto trajnime janë: sjellja e eksperiencave më pozitive dhe të mundshme për tu aplikuar në vendin tonë, eksperiencë jo vetëm japoneze, por dhe nga vende të tjera që ofrojnë modele të mundshme për t'u përshtatur në kushtet shqiptare.

Ndihma e Qeverisë Japoneze po konsiston dhe në sjelljen e pajisjeve dhe materialeve të nevojshme që do i duhen ekspertëve që të zhvillojnë punën e tyre gjatë tre vjetëve të projektit në Shqipëri.

Në kuadër të këtij projekti janë përzgjedhur 3 njësi administrative për t'u zbatuar projekti pilot. Njësitë e përzgjedhura janë: komuna e Bushatit, e cila ka si kriter përzgjedhjeje se përfaqëson njësi administrative të vogël: është përzgjedhur bashkia Lezhë, si njësi administrative e madhësisë së mesme; si dhe Bashkia e Tiranës, si njësi administrative e madhe.

Ministria e Mjedisit mbështetur dhe në Strategjinë e Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve ka konceptuar dhe një projekt, i cili të reflektojë zbatimin e hapave të hierarkisë së mbetjeve, hapa të cilat do të mundësojnë reduktimin sa më të madh të mbetjeve që duhet të shkojnë në landfill. Ky projekt ide ka gjetur mbështetjen financiare dhe të Qeverisë Italiane. Projekti do përfshijë institucionet qendrore dhe të varësishme si dhe institucionet arsimore publike për Qarkun e Tiranës. Në këto institucione mbetjet do të mblidhen në mënyrë të diferencuar: letër, plastika dhe materialet e aluminit (kanaçe), këto lloje mbetjesh nuk do të hidhen më në landfill, por do t'i kalojë biznesit riciklues në Shqipëri prej të cilës përfitohet lëndë e

parë, për prodhimin e elementëve të tjerë të kërkuara në treg.

Për realizimin e këtij projekti do të mundësohet vendosja e koshave me ngjyra të ndryshme nëpër institucione, për grumbullimin e ndarë të këtyre mbetjeve,

Gjithashtu Ministria e Mjedisit ka ideur dhe një projekt për rikthimin e mbetjeve nga ambalazhet. Është ende në proces ndërtimi i skemës që do të aplikohet për rikthimin e mbetjeve nga ambalazhet. Kështu po shihet mundësia e kthimit të mbetjeve nga ambalazhet në pikat e grumbullimit kundrejt përfutimit të një sasive të hollash. Ky proces është ideuar të fillohet fillimisht me rikthimin e ambalazheve të plastikës dhe të aluminit. Më pas procesi i kthimit të ambalazheve do të vijojë dhe me materialet më përbërës qelqi dhe të kutive të kartonit (Tetra Pack).

Kjo lloj sjelljeje do të ndihmojë në reduktimin e sasive të mbetjeve që dërgohen në landfill duke përdorur modelin e motivimit për qytetarët. Pikat e grumbullimit do të jenë në supermarkete/minimarkete si edhe në postat shqiptare. Grumbullimi do të jetë manual ose automatik. Çdo pije e ambalazhuar do të pajiset me një etikete sigurie para hedhjes në treg, e cila duhet të jetë e padëmthuar në momentin e rikthimit të ambalazheve.

Ministria e Mjedisit po planifikon modele pilote, pasi do jetë më e lehtë më pas që përvojën e fituar ta aplikosh në rang kombëtar, për më tepër kjo lloj metode sjell dhe përmirësimin e mekanizmave veprues, të cilat deri tani në Shqipëri nuk funksiononin.

Në trajnimet që ka ndërmarrë Ministria e Mjedisit me të gjitha autoritetet lokale në të gjitha prefekturat e vendit, i ka njohur autoritetet lokale që deri në vitin 2015 duhet të reduktohet në 15 % masa e mbetjeve që duhet të shkojë në landfill.

Gjithashtu Ministria e Mjedisit po punon dhe në fushën e edukimit mjedisor për fëmijët e shkollave, ku elementi kryesor që do ju jepet fëmijëve është të respektojnë mjedisin, ku ata jetojnë dhe të kujdesen që jo gjithçka që ata konsumojnë mund të jetë një mbetje, ajo mund të jetë dhe lëndë e parë për të prodhuar diçka përsëri me vlerë për ta.



THËNIA E MUAJIT

“Mjedisi është vendi, ku ne të gjithë takohemi; ku të gjithë zhvillojmë interesat tona; si dhe i vetmi vend i përbashkët që ne ndajmë”

Lady Bird Johnson

SEKTORI I TRANSPARENCËS DHE KOMUNIKIMIT

Email: info@moe.gov.al

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE



Në datat 26 dhe 27 Maj, u zhvillua aktiviteti “Trajnimi në teori i guidatorëve për guidën nënujore”, në Vlorë, në mjediset e shoqatës SEEP “Edukimi Social dhe Mbrojtja e Mjedisit”. Në këtë trajnim morën pjesë rreth 15 të rinj. Prezantimi u bë nga kryetari i shoqatës Ekolëvizja z. Xhemal Mato. Gjatë trajnimit të rinjtë morën njohuri mbi teknikat e zhytjes, mbi mjeksinë dhe mbi praktikën e zhytjes.

Pjesa që tërhoqi vëmendjen më të madhe të pjesëmarrësve ishte sesioni i mjekësisë së zhytjes. Ndryshimet që pësonte trupi gjatë thellësive të ndryshme dhe koha që nevojitej për të dalë në sipërfaqe i pakomprimuar ishte pjesa në të cilën u ndalua më tepër. Kjo për arsye të rëndësishme që kishte dhe vështirësisë në llogaritje të kohës së qëndrimit në thellësi të caktuara.

Turizmi nënujor është një nga industritë më të suksesshme sot në vendet e zhvilluara. Ka shumë shqiptarë, rezidentë të huaj, punonjës të ambasadave, fondacioneve, turista të huaj verorë që duan ta ushtrojnë këtë lloj turizmi, nisur nga kureshtja për të parë botën nënujore të bregdetit tonë, mjaft e pasur me histori, peizazhe dhe biodiversitet por të pa identifikuar dhe mirëmenaxhuara nga agjensitë tona turistike. Por ndonëse bregdeti i Karaburunit dhe Sazanit është vlerësuar nga specialistët përkatës si një nga pesë pikat më të pasura dhe më të bukura të Mesdheut , nuk ka asnjë agjensitë që të punojë me turizmin bregdetar- nënujor.

Ky trajnim u mundësua nga Qendra “Grupimi Ekolëvizja” në bashkëpunim me Shoqatën SEEP (Edukimi Social dhe Mbrojtja e Mjedisit) , projekt i cili mbështetet financiarisht nga Shoqata e Ruajtjes

dhe e Mbrojtjes së Mjedisit Natyror në Shqipëri (PPNEA).

TRAJNIM MBI NDRËHYRJEN MJEDISORE DHE ZGJIDHJEN E KONFLIKTEVE PËR VENDET E EVROPËS JUGLINDORE



Gjatë ditëve, 29– 30 Qershor 2015, në qytetin e Shkodrës u organizua trajnimi mbi “Ndërhyrjen Mjedisore dhe Zgjidhjen e Konfliktëve për vendet e Evropës Juglindore” i financuar nga fondi Austriak i Bashkëpunimit për Zhvillim dhe i mundësuar nga REC. Në këtë trajnim interaktiv mermin pjesë përfaqësues nga Shqipëria Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Bosnje Hercegovina dhe Kosova. Në këtë trajnim u mundësua dhënia e teknikave për zgjidhjen e konfliktëve sidomos ato mjedisore, roli i lehtësuesit (moderatorit) të aktiviteteve në mjedis që përbajnë konflikt në vetvete. U përvetësuan nga të pranishmit mënyra e negociimit në proceset vendim-marrëse, u dhanë elementët kryesorë të ndryshimit mes këshillimit dhe konsultimit. Gjithashtu të pranishmit u njohën me 5 teknikat për të gjetur një zgjidhje të pranueshme nga palët.

Ky trajnim interaktiv dy ditor ishte mjaft efikas, pasi mësohej nëpërmjet veprimtimit të vetë të pranishmëve. Pjesa teorike u mundësuar nga z. Eölgang Pfeiffkov dhe znj. Hana Posch, të cilët drejtuan me mjaft profesionalizëm këtë aktivitet rajonal.

DIVJAK- KOLONI RE E ÇAFKAVE DHE KARABULLAKËVE



Shoqata mjedisore e krijuar muajt e fundit, ASOS Albania nëpërmjet rrjeteve sociale, informon për një zbulim interesant në zonën e Kularit (Parku Kombëtar Divjakë-Karavasta). Një koloni re e çafkave dhe karabullakëve janë gjetur në ditët e fundit të Qershorit 2015, në Parkun Kombëtar të Divjakës Karavastës. Është një gjetje vërtet e rëndësishme duke marrë parasysh që kjo është e vetmja koloni e tillë në Shqipëri ndërsa të tjerat të ndodhura dikur me ne veri (delten e Drinit dhe Velipojë) janë zhdukur që prej 20 vjet më parë.

Siç informon kjo shoqatë “kolonia ndodhet në zonën e Kularit, të kufizuar në veri nga lumi i Shkumbinit, në lindje nga zona kënetore, në jug nga kanali i Tërbufit dhe në perëndim nga rrjedha e vjetër e Shkumbinit.

Foletë ishin ndërtuar mbi një pyll marinash të permbytura, në një zonë që përdoret edhe si fjetore për Çafkat dhe Karabullakët.

Aksesi është shumë i vështirë për shkak të nivelit të lartë të ujërave dhe dendësisë së kallamishteve dhe pemëve. Kolonia përbëhet nga 400-600 fole. Pjesa më e madhe i takon Karabullakut të vogël (Phalacrocorax pygmeus). Llojet e tjera folezuese janë çafka e natës (Nycticorax nycticorax), Çafka e verdhë (Ardeola ralloides), Çafka e vogël e bardhë (Egretta garzetta) dhe ndoshta Çafka e madhe e bardhë (Egretta alba), Çafka e përhime (Ardea cinerea) dhe Karabullaku i madh (Phalacrocorax carbo)”.